

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8296  
E enjte, 7 maj 2026  
Çmimi 0.50 €

Kosova dhe Mbretëria  
e Bashkuar forcojnë  
partneritetin në mbrojtje  
dhe siguri | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SHTYRJA E RADHËS E VENDIMIT PËR KRERËT E UÇK-SË, VENDIM I PASTËR POLITIK

## PASTËRTIA E LUFTËS SË UÇK-SË DO TË TRIUMFOJË MBI ÇDO INTRIGË DHE MBI ÇDO GJYKATË | FAQE 4-5



Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe organizata "Liria ka emër" kanë thënë se shtyrja e radhës e vendimit për krerët e UÇK-së deri më 20 korrik nga Gjykata Speciale nuk është gjë tjetër

veçse vendim i pastër politik. Sipas tyre, kjo vonesë e pajustificueshme është dëshmi e radhës e këtij procesi të stërzgatur, i cili e ka humbur kuptimin e drejtësisë dhe është shndërruar në një proces të ndikuar nga kalkulimet politike.

Po ashtu, Avokati i Popullit i ka shkruar letër sekretarit të ShBA-së dhe shteteve financuese për raportin e fundit nga organizata britanike mbi Dhomat e Specializuara, ku identifikohen shqetësime serioze lidhur me këtë proces gjyqësor

### AKTUALE



TRUMPI THOTË SE DO TA PEZULLOJË OPERACIONIN PËR SHOQËRIMIN E ANIJEVE NË NGUSHTICËN E HORMUZIT | F. 2

LDK-ja PAJTOHET TË GAROJË SË BASHKU ME ISH-PRESIDENTEN OSMANI NË ZGJEDHJET E QERSHORIT | F. 6

KONJUFCA NË IRLANDË KËRKON MBËSHTETJE PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË BE | F. 3

### EKONOMI



AKSION NË AGJENCINË KADASTRALE, DYSHIME PËR FALSIFIKIM DOKUMENTESH DHE KEQPËRDORIM TË DETYRËS ZYRTARE | F. 8

KEK-u NDAL NJËSINË A4 SI PASOJË E RRJEDHJEVE TË UJIT NË KALDAJË | F. 8

### SPORT



KOMITETI EKZEKUTIV I FFK-së VLERËSON POZITIVISHT ECURINË E GARAVE DHE PËRPARIMIN E EKIPEVE KOMBËTARE | F. 11



RAMA PAS KOALICIONIT ME PDK-në: QYTETARËT SJETOJNË NË PARTI, KOSOVA S'KA NEVOJË PËR MË SHUMË KRIZË E POLARIZIM | F. 3



ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT: 18 PARTI KONFIRMOJNË PJESËMARRJEN, NJË KOALICION I FORMUAR | F. 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# TRUMPI THOTË SE DO TA PEZULLOJË OPERACIONIN PËR SHOQËRIMIN E ANIJEVE NË NGUSHTICËN E HORMUZIT

WASHINGTON, 6 MAJ - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka njoftuar se operacioni i quajtur "Project Freedom" për shoqërimin e anijeve përmes Ngushticës së Hormuzit do të "pezullohet për një periudhë të shkurtër kohore", pasi është arritur "përparim i madh drejt një marrëveshjeje të plotë dhe përfundimtare me përfaqësuesit e Iranit".

Në një postim në "Truth Social" të mërkurën herët, Trumpi tha se vendimi u mor me kërkesë të Pakistanit, i cili po ndërmjetëson bisedimet mes ShBA-së dhe Iranit, "për të parë nëse marrëveshja mund të finalizohet dhe nënshkruhet".

ShBA-ja e nisi të ashtuquajturin "Project Freedom" për ta rihapur Ngushticën Hormuzit për anijet tregtare, pasi Irani e ka mbyllur atë duke lënë mijëra anije të bllokuara në të dyja anët e ngushticës për javë të tëra, që ka goditur rëndë ekonominë botërore.

Irani e ndaloi kalimin përmes kësaj rruge jetike ujore, duke kërcënuar se do të shënjestrojë çdo mjet lundruar që do të përpiqet të kalojë pa pëlqimin e tij, për shkak të fushatës ushtarake të ShBA-së dhe Izraelit kundër tij, e cila nisi më 28 shkurt.

Njoftimi i Trumpit erdhi pas një konference për shtyp nga sekretari i Shtetit, Marco Rubio, i cili deklaroi se fushata ushtarake amerikane kundër Iranit, e quajtur "Tërbimi Epik", ka përfunduar.

Disa orë më parë, sekretari i Mbrojtjes, Pete Hegseth, tha se armëpushimi i ShBA-së me Iranin mbetet në fuqi, edhe pse Irani lëshoi raketa drejt Emirateve të Bashkuara Arabe dhe ushtria amerikane fundosi gjashtë varka të vogla iraniane



më 4 maj.

Jo shumë kohë pasi Hegseth foli në një konferencë për shtyp në Pentagon të martën, Emiratet e Bashkuara Arabe, aleatët e ShBA-së në rajonin e Gjirit, raportuan për një valë tjetër raketash iraniane. Nuk u raportua për dëme apo të lënduar.

Shkëmbimi i zjarrit ka shtuar frikën se armëpushimi i shpallur pothuajse një muaj më parë ishte prishur dhe se luftimet e përgjithshme nga Teherani, si dhe nga forcat amerikane dhe izraelite, mund të rifillojnë.

Forcat detare amerikane filluan t'i shoqërojnë disa nga anijet tregtare që ishin bllokuar në Gjirin Persik si pasojë e mbylljes së Ngushticës së Hormuzit nga Irani, e cila është pikë strategjike detare.

Duke folur me gazetarët në Pentagon, Hegseth tha se ky operacion ishte vetëm një "zgjidhje e përkohshme" dhe kërkoi sërish që Irani ta heqë bllokadën.

Anijet luftarake amerikane, po ashtu, po i bllokojnë portet iraniane si kundërpërgjigje. "Iranit nuk mund t'i lejohet t'i bllokojë vendet e pafajshme dhe mallrat e tyre në një rrugë ujore ndërkombëtare", tha Hegseth për gazetarët. Iranianët "thonë se e kontrollojnë ngushticën. Nuk është e vërtetë", shtoi ai.

## "Armëpushimi nuk ka përfunduar"

I pyetur për armëpushimin, Hegseth tha: "Armëpushimi nuk ka përfunduar". "Ne kemi thënë se do të mbrohemi edhe në mënyrë agresive. Këtë e kemi bërë. Irani e di këtë, e në fund presidenti mund të vendosë se kur ka ndodhur përshkallëzimi deri në shkeljen e armëpushimit", tha ai.

Gjenerali Dan Caine, kryetar i shefave të Shtabit të Përbashkët të ShBA-së, tha se Irani ka sulmuar forcat amerikane "me

shumë se 10 herë" që nga armëpushimi i 8 prillit. Megjithatë, ai tha se kjo "nuk e kaloi pragun për rifillimin e operacioneve të mëdha luftarake".

Rreth 22 500 detarë në më shumë se 1 550 anije tregtare janë të bllokuar në Gjirin Persik, pa pasur mundësi ta kalojnë ngushticën, tha Caine.

Duke folur për "Fox News" më 4 maj, Trumpi e paralajmëroi sërish Iranin që të mos shënjestrojë anijet amerikane, duke e paralajmëruar se do të fshijë nga faqja e dheut nëse e bën këtë.

Ndërkohë, sekretari i Shtetit, Marco Rubio, tha se operacioni fillestar ushtarak ka përfunduar dhe theksoi se bllokada amerikane e porteve iraniane është thjesht mbrojtëse. "Ne përgjigjemi vetëm nëse sulmohemi të parët. Ky është një operacion mbrojtës", tha Rubio. "Nëse nuk qëllohet ndaj këtyre anijeve dhe ndaj nesh, ne nuk do të qëllojmë, e nëse qëllohemi, do të përgjigjemi".

## Raketa të tjera drejt Emirateve të Bashkuara Arabe

Rreth dy orë pasi përfundoi konferenca e Hegseth në Pentagon, Ministria e Mbrojtjes e Emirateve të Bashkuara Arabe njoftoi se ka vërejtur raketa dhe dronë iraniane. "Sistemet e mbrojtjes ajrore të Emirateve janë të angazhuara aktivisht kundër kërcënimeve me raketa dhe dronë", njoftoi Ministria në X.

Një ditë më parë Emiratet reagues me zemërim, duke kërcënuar me kundërpërgjigje pasi katër raketa iraniane u lëshuan drejt tyre. Tri u rrëzuan nga mbrojtja ajrore, ndërsa e katërta ra në det.

Gjatë armëpushimit të brishtë, Teherani dhe Uashingtoni kanë shkëmbyer propozime për një marrëveshje paqeje.

Një nga pengesat më të mëdha janë synimet bërthamore të Iranit. Uashingtoni kërkoi që Teherani të heqë dorë nga uraniumi, përfshirë uraniumin e pasuruar në nivele të larta, i cili mund të përdoret për ndërtimin e armëve bërthamore.

Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme iraniane, Esmail Baqaei, u citua të ketë thënë se në këtë fazë nuk ka bisedime për kapacitetet bërthamore të Iranit. Duke folur në Departamentin e Shtetit, Rubio tha se është koha që Teherani ta "pranojë realitetin e situatës" dhe se përmes zgjidhjes diplomatike duhet të trajtohet çdo material bërthamor që Irani ende e mban të fshehur.

"Presidenti ka qenë i qartë se pjesë e procesit të negociatave duhet të jetë jo vetëm pasurimi, por edhe çfarë ndodh me këtë material që është i varrosur thellë diku dhe që ata ende kanë qasje në të nëse duan ta nxjerrin", tha Rubio.

## Zvicra regjistron një rast të hantavirusit

Cyrih, 6 maj - Autoritetet zvicerane kanë konfirmuar një rast infektimi me hantavirus te një pasagjer i anijes turistike MV Hondius, i cili është paraqitur në një spital në Cyrih, ku aktualisht po merr trajtim mjekësor. Sipas njoftimit, pasagjeri reagoi ndaj një e-maili informues nga operatori i anijes për një incident shëndetësor në bord, pas së cilës ai vetë u paraqit pranë autoriteteve shëndetësore në Zvicër.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka bërë me dije se, në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, po bashkëpunon me

institucionet përkatëse të disa vendeve për ta realizuar gjurmimin ndërkombëtar të kontakteve.

Qëllimi është identifikimi i personave që mund të jenë ekspozuar ndaj virusit dhe parandalimi i përhapjes së mëtejshme.

Është konfirmuar se bëhet fjalë për hantavirusin Andes, ndërsa identifikimi është kryer nga Instituti Kombëtar për Sëmundje Infektive i Afrikës së Jugut dhe Spitali Universitar në Gjenevë.

Në reagimin ndaj këtij rasti shëndetësor kanë marrë pjesë edhe institucione të tjera ndërkombëtare, përfshirë

Institutin Pasteur në Dakar (Senegal) dhe Administratën Kombëtare të Laboratorëve dhe Instituteve Shëndetësore të Argjentinës.

Sipas të dhënave të fundit deri më 6 maj, janë regjistruar gjithsej tetë raste, prej të cilave tre janë konfirmuar në laborator si hantavirus.

OBSH-ja ka paralajmëruar vazhdimin e bashkëpunimit me shtetet për t'u siguruar pasagjerëve, ekuipazhit dhe kontakteve informacion dhe mbështetje në kohë, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e përhapjes së mëtejshme të infeksionit.



## Konjufca në Irlandë kërkon mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në BE

PRISHTINË, 6 MAJ - Ministri i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës i Kosovës, Glauk Konjufca, ka zhvilluar vizitën e parë bilaterale në Irlandë, ku është takuar me ministren për Punë të Jashtme dhe Tregti, Helen McEntee. Gjatë takimit palët diskutuan për marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Irlandës, duke vlerësuar miqësinë mes dy popujve dhe vlerat e përbashkëta. U theksua nevoja për zgjerimin dhe shtimin e bashkëpunimit

në fusha të ndryshme. Në kuadër të diskutimeve, Konjufca kërko mbështetjen e Irlandës për pranimin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian, veçanërisht në prag të marrjes së Presidencës së BE-së nga Irlanda. "Po ashtu, duke qenë se Irlanda do ta marrë drejtimin e Presidencës së Bashkimit Evropian, kërkuam mbështetjen e saj në pranimin e aplikimit të Kosovës për anëtarësim në BE. U dakorduam që Kosova nuk

mund të veçohet nga procesi dhe përcaktimi i anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian", ka deklaruar Konjufca. Gjatë vizitës ministri Konjufca u takua edhe me anëtarë të Komitetit të Përbashkët për Çështjet e Bashkimit Evropian të Parlamentit irlandez si dhe me senatorin Pat Casey, takime në të cilat u riafirmua mbështetja parlamentare e Irlandës për rrugën evropiane të Kosovës.



## RAMA PAS KOALICIONIT ME PDK-NË: QYTETARËT S'JETOJNË NË PARTI, KOSOVA S'KA NEVOJË PËR MË SHUMË KRIZË E POLARIZIM

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 MAJ - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se duhet stabilitet institucional, bashkëpunim dhe vendimmarrje e përgjegjshme për kryeqytetin pasi, së fundmi, arriti marrëveshje koalicioni me Partinë Demokratike të Kosovës, për të cilën Lidhja Demokratike e Kosovës tha se "nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar" të kësaj partie. Rama ka shkruar në "Facebook" se qeverisja është, në thelb, përgjegjësi ndaj qytetarit. "Prandaj, obligimi ynë moral dhe politik është i qartë: të ofrojmë qeverisje që u shërben qytetarëve me përgjegjësi, bashkëpunim dhe respekt të ndërsjellë. Politika nuk duhet të jetë qëllim në vetvete, por mjet për të realizuar të mirën publike: për qytetarin. Sot, Prishtina ndodhet para një momenti të rëndësishëm historik dhe zhvillimor. Me projektet madhore që na presin, përfshirë përgatitjet për Lojërat Mesdhetare, ne nuk po ndërtojmë vetëm infrastrukturë moderne, por po ndërtojmë identitetin dhe perspektivën e një kryeqyteti evropian, funksional dhe konkurrues. Këto procese kërkojnë stabilitet institucional, bashkëpunim dhe vendimmarrje të përgjegjshme. Në një rend demokratik, dallimet janë të



natyrshme dhe legjitime. Por pjekuria politike matet me aftësinë për t'i tejkaluar ato në funksion të interesit të përbashkët. Qytetarët nuk jetojnë në parti, jetojnë në komunitet të përbashkët, prandaj ata janë përgjegjësi e përbashkët. Nevojat e tyre nuk janë çështje interpretimi politik, por detyrim për zgjidhje konkrete të menjëhershme", ka thënë Rama, duke shtuar se është kundër çdo retorike përçarëse. "Ne jemi një

popull. Një shtet. Prandaj, duhet vizion i përbashkët, stabilitet dhe veprime të përgjegjshme institucionale nga secili prej nesh. Duke vendosur qytetarin në qendër dhe duke qenë të vetëdijshëm se pushteti është shërbim, e jo instrument bllokimi, kemi finalizuar bashkëqeverisjen në Kryeqytet me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nismën Socialdemokrate, Lidhjen për Prishtinën dhe së fundmi me Partinë Demokratike të Kosovës

(PDK). Në këtë kuadër, emërimet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), janë bërë konform propozimeve të ardhura nga 'Kolegjiumi' i përbërë nga 5 degët e Prishtinës, një mekanizëm i themeluar nga vetë LDK, që garanton përfaqësim, balancë dhe legjitimitet të brendshëm. Paralelisht, janë emëruar edhe përfaqësuesit e partnerëve tanë nga AAK, Nisma, Lidhja për Prishtinën dhe PDK, duke reflektuar një qasje

gjithëpërfshirëse dhe funksionale", ka thënë ai. Rama ka deklaruar se kryeqyteti është shembull i bashkëpunimit dhe zhvillimit dhe ashtu do të mbetet. "Shpreh mirënjohje të veçantë për drejtorët e deritanishëm, të cilëve u ka përfunduar mandati, për profesionalizmin dhe kontributin e tyre të çmuar në shërbim të qytetit. Ndërsa drejtorëve të rinj u uroj suksese dhe përgjegjësi të lartë në detyrat që marrin përsipër. Ashtu siç e kam përkrahur pakusht Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) në zgjedhjet e kaluara, do ta përkrah edhe në këto zgjedhje, me bindjen se demokracia, stabiliteti institucional dhe kultura shtetformuese duhet të mbrohen dhe të forcohen vazhdimisht. Përgjegjësi, rend, zhvillim dhe shërbim ndaj qytetarit, pa retorikë përçarëse por me vizion të qartë për të ardhmen, kjo është filozofia e së djathtës! Kosova nuk ka nevojë për më shumë krizë e polarizim, por për institucione funksionale, bashkëpunim dhe vizion për zhvillim. Sepse lidhshipi i vërtetë nuk matet me aftësinë për të krijuar tension, por me aftësinë për të bashkuar njerëzit, për të ndërtuar stabilitet institucional, dhe për ta çuar vendin përpara", është shprehur kryetari i Prishtinës, Përparim Rama.

## Haradinaj në përvjetorin e vëllait, Luanit: Krenaria për sakrificën dhe heroizmin e tij mbizotëron mbi dhimbjen

DEÇAN, 6 MAJ - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar të mërkurën në Deçan dhe në Kompleksin Memorial në Glogjan heroin e Kosovës, gjeneralmajor Luan Haradinaj, si dhe veprimtarin e çështjes kombëtare, Smajl Haradinaj.

Në këtë ditë përkujtimore, që përkon edhe me 6 majin, datën e lindjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, u shënuar edhe 29-vjetori i rënies së Luan Haradinajt. Gjatë homazheve u theksua roli i Luan Haradinajt në organizimet çlirimtare dhe ndikimi i tij në mobilizimin e

luftëtarëve që iu bashkuan rrugës së lirisë deri në fitore. Ramush Haradinaj vlerësoi se sakrificat dhe heroizmi i tij, si dhe i bashkëluftëtarëve, përbëjnë themelin e lirisë së Kosovës. Ai theksoi se, pavarësisht prej dhimbjes, krenaria për sakrificën dhe heroizmin e tyre do të mbizotërojë gjithmonë.





SHTYRJA E RADHËS E VENDIMIT PËR KRERËT E UÇK-së, VENDIM I PASTËR POLITIK

# PASTËRTIA E LUFTËS SË UÇK-së DO TË TRIUMFOJË MBI ÇDO INTRIGË DHE MBI ÇDO GJYKATË

Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe organizata "Liria ka emër" kanë thënë se shtyrja e radhës e vendimit për krerët e UÇK-së deri më 20 korrik nga Gjykata Speciale nuk është gjë tjetër veçse vendim i pastër politik. Sipas tyre, kjo vonesë e pajustificueshme është dëshmi e radhës e këtij procesi të stërzgatur, i cili e ka humbur kuptimin e drejtësisë dhe është shndërruar në një proces të ndikuar nga kalkulimet politike. Po ashtu, Avokati i Popullit i ka shkruar letër sekretarit të ShBA-së dhe shteteve financuese për raportin e fundit nga organizata britanike mbi Dhomat e Specializuara, ku identifikohen shqetësime serioze lidhur me këtë proces gjyqësor

EPOKA E ENJTE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 6 MAJ - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë se shtyrja e radhës e vendimit për krerët e UÇK-së deri më 20 korrik nga Gjykata Speciale nuk është asgjë tjetër veçse një vendim i pastër politik dhe një padrejtësi e radhës që rëndon mbi kurrizin e historisë sonë. "Që nga fillimi i këtij procesi ne nuk pamë transparencë, paanshmëri dhe drejtësi të vërtetë. Në vend të tyre, pamë vetëm montime dhe

padrejtësi të veshura me petkun e ligjit. Po tentojnë ta gjykojnë lirinë, por liria nuk mund të prangoset. Burrat e mëdhenj të kombit, që sot po mbahen padrejtësisht në Hagë, janë vetë dëshmia e sakrificës sonë për ekzistencë. Mund ta vonojnë, por kurrë nuk do ta mposhtin të vërtetën. Në fund, pastërtia e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do të triumfojë mbi çdo intrigë e çdo gjykatë", ka thënë Gucati. Edhe Partia Demokratike e Kosovës ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me shtyrjen e shpalljes së

aktgjyqimit në procesin gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Gjykatën Speciale në Hagë. "Kjo vonesë e pajustificueshme është një dëshmi e radhës e këtij procesi të stërzgatur, i cili e ka humbur kuptimin e drejtësisë dhe është shndërruar në një proces të ndikuar nga kalkulimet politike. Shtyrja e fundit është një goditje tjetër ndaj besimit tonë në drejtësi dhe një padrejtësi e shtuar ndaj ish-krerëve të UÇK-së, të cilët prej rreth pesë vitesh e gjysmë po mbahen në paraburgim, duke ua shndërruar këtë masë në një

dënim të heshtur të imponuar përmes vonesave të përsëritura", është thënë në reagimin e PDK-së.

PDK-ja i bën thirrje bashkësisë ndërkombëtare dhe institucioneve të drejtësisë që të reflektojnë dhe të mos lejojnë që ky proces të shndërrohet në një shembull të dështimit të drejtësisë ndërkombëtare. PDK-ja ka theksuar se mbetet e palëkundur në bindjen për pafajësinë e ish-krerëve të UÇK-së dhe kërkon një vendim përfundimtar, pa vonesa të mëtejshme, i cili do të mundësojë rikthimin e tyre në Kosovë.

Organizata "Liria ka emër" e konsideron tërësisht të papranueshme shtyrjen e shpalljes së aktgjyqimit në procesin gjyqësor ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Gjykatën Speciale në Hagë.

Kjo praktikë e vazhdueshme e vonesave të paarsyeshme nuk mund të shihet më si procedurë normale gjyqësore, por si një degradim serioz i parimeve

themelore të drejtësisë për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Ky proces që po zvarritet për vite të tëra, me shtyrje të përsëritura, e ka humbur tërësisht kredibilitetin dhe është shndërruar tashmë në një mekanizëm që prodhon padrejtësi të vazhdueshme. Mbajtja e ish-krerëve të UÇK-së për gati gjashtë vjet në paraburgim bie ndesh me çdo standard të drejtësisë ndërkombëtare dhe të drejtave themelore të njeriut.

"Liria ka emër" vlerëson se këto zhvillime po e dëmtojnë rëndë besimin e qytetarëve në institucionet e drejtësisë ndërkombëtare, duke krijuar perceptimin e një procesi të zvarritur, të pabalancuar dhe të papërgjegjshëm.

"Liria ka emër" paralajmëron se çdo shtyrje e mëtejshme në këtë proces gjyqësor në Gjykatën Speciale, këtë institucion vetëm sa e largon edhe më shumë nga standardet e drejtësisë, duke e shndërruar në një precedent të rrezikshëm për drejtësinë ndërkombëtare.



## Gucati me bashkëpunëtorë dorëzuan në Speciale 200 mijë nënshkrime për çlirimtarët

Kryetari i OVLUÇK-së, Hyseni Guçati, së bashku me bashkëpunëtorë ka dorëzuar të mërkurën në Gjykatën Speciale në Hagë 200 mijë nënshkrime që janë firmosur në mbrojtje të çlirimtarëve. "Sot në Gjykatën Speciale në Hagë u dorëzuan 200 mijë nënshkrime, 200 mijë zëra që kumbojnë me një kërkesë të vetme: Drejtësi për çlirimtarët. Ky nuk është thjesht një peticion, është vullneti i pastër i një kombi që nuk e harron sakrificën. Me besimin e palëkundur te lufta e pastër e UÇK-së, urojmë dhe shpresojmë që këtë verë dielli të lindë ndryshe me krerët tanë në shtëpi, aty ku e kanë vendin, në Kosovën e lirë!", ka shkruar Guçati në "Facebook".

### Avokati i Popullit i shkruan sekretarit të ShBA-së dhe shteteve financuese për raportin mbi Dhomat e Specializuara

Avokati i Popullit, Naim Qelaj, u ka dërguar letër shteteve financuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës nëpërmjet së cilës ua ka përcjellë edhe raportin "Vlerësimi paraprak i Dhomave të Specializuara të Kosovës" dhe ka paraqitur shqetësimet e tij të bazuara në gjetjet e këtij raporti. Kjo letër, e përcjellë nëpërmjet kanaleve diplomatike, i është dërguar sekretarit të Shtetit të ShBA-së, Marco Rubio, si dhe Departamentit të Drejtësisë së ShBA-së. Letra informuese u është dërguar ministrit të Punëve të Jashtme të Zvicrës, të Norvegjisë, të Turqisë dhe të Kanadasë. Raporti u është dërguar Ursula von der Leyen, presidente e Komisionit Evropian, Kaja Kallas, përfaqësuese e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri e BE-së, Roberta Metsola, presidente e Parlamentit Evropian, Despina Chatzivassiliou-Tsovili, sekretare e Përgjithshme e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Alain Berset, sekretar i përgjithshëm i Këshillit të Evropës, dhe

Michael O'Flaherty, komisionar për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës.

Në këtë letër, Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimet lidhur me garancitë për një gjykim të drejtë gjatë procedurave në Dhomat e Specializuara të Kosovës, të identifikuar nga organizata "Bar Human Rights Committee of England and Wales" (BHRC) - Komiteti i Odës së Avokatëve për të Drejtat e Njeriut i Anglisë dhe Uellsit.

Qelaj i ka informuar ata se Institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar vazhdimisht përputhshmërinë me të drejtat themelore në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) si dhe kushtet e të parburgosurve. Ai thekson në letër se, si pjesë e këtyre përpjekjeve, ka angazhuar organizatën BHRC për të kryer një vlerësim paraprak të pavarur si rezultat i shqetësimeve të tij serioze dhe të vazhdueshme lidhur me respektimin e të drejtave themelore në kuadër të procedurave gjyqësore në DhSK.

Raporti në fjalë ka identifikuar shqetësime serioze lidhur me mbrojtjen e garancive themelore procedurale që u ofrohen të akuzuarve, në veçanti me të drejtën për një gjykim të drejtë, transparent dhe të paanshëm. Këto parime përbëjnë garanci themelore në

kuadër të së Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtësisë Penale Ndërkombëtare.

Në këtë letër u nënvizua se e drejta për një gjykim të drejtë është e përcaktuar në nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të dyja të zbatueshme drejtpërdrejt në rendin juridik të Kosovës nëpërmjet Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Këto dispozita garantojnë, ndër të tjera, të drejtën e çdo individit për një seancë të drejtë dhe publike para një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të krijuar me ligj; prezumimin e pafajësisë; kohë dhe lehtësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes; barazinë e armëve ndërmjet

prokurorisë dhe mbrojtjes; si dhe transparencën në procedurat gjyqësore. Këto standarde të njohura ndërkombëtarisht përbëjnë mbrojtje thelbësore për të siguruar legjitimitetin dhe besueshmërinë e procedurave penale të zhvilluara në kuadër të mekanizmave gjyqësorë ndërkombëtarë ose hibridë, thuhet në letër.

Avokati i Popullit thekson rëndësinë e sigurimit që praktikant dhe procedurat e gjykatës të vazhdojnë t'u përmbahen plotësisht standardeve më të larta ndërkombëtare të drejtësisë, transparencës dhe pavarësisë gjyqësore. Ai shtoi se adresimi i shqetësimeve të identifikuar në raport është thelbësor jo vetëm për mbrojtjen e të drejtave procedurale të të akuzuarve, por

edhe për ruajtjen e besueshmërisë dhe integritetit të procesit gjyqësor.

Avokati i Popullit ka rikujtuar në letër se Republika e Kosovës ka demonstruar vazhdimisht angazhimin e saj ndaj parimeve të drejtësisë ndërkombëtare, llogaridhënies dhe sundimit të ligjit.

Më tutje, theksohet se Republika e Kosovës ka përmbushur detyrimet e saj ndërkombëtare duke themeluar Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese dhe miratimit të legjislacionit zbatues nga institucionet e saj demokratike. Avokati i Popullit nënvizon gatishmërinë e qartë dhe të pakontestueshme të Kosovës për të kontribuar në mekanizmat ndërkombëtarë të llogaridhënies dhe për t'i mbështetur standardet më të larta të drejtësisë. Në këtë letër, Avokati i Popullit, po ashtu, thekson se përfaqësuesit e lartë politikë të Kosovës janë dorëzuar vullnetarisht në juridiksionin e Gjykatës për t'u përballur me akuzat e ngritura kundër tyre. Ai shtoi se një sjellje e tillë tregon një angazhim të fortë institucionin nga Republika e Kosovës dhe udhëheqja e saj politike ndaj parimeve të llogaridhënies, bashkëpunimit gjyqësor dhe respektimit të proceseve ligjore ndërkombëtare.

## ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT: 18 PARTI KONFIRMOJNË PJESËMARRJEN, NJË KOALICION I FORMUAR

PRISHTINË, 6 MAJ - Kur ka mbetur vetëm edhe një ditë afat për partitë politike për të njoftuar ose pjesëmarrjen në zgjedhje ose deklarimin e koalicioneve, disa nga partitë politike e kanë kryer këtë obligim ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë për RTK-në se deri më tani (e mërkurë, 6 maj 2026, ora 12:00), KQZ ka pranuar njoftimin për pjesëmarrje në zgjedhje nga 18 parti politike; mospjesëmarrjen nga 4 të tjera dhe formimin e 1 koalicioni të përbërë nga 2 parti politike. “Është duke vazhduar periudha për partitë politike të regjistruara në Republikën e Kosovës për ta njoftuar KQZ-në për: pjesëmarrje ose mospjesëmarrje në zgjedhje dhe formim të koalicioneve. Kjo periudhë ka filluar më 1 maj dhe do të përfundojë më 7 maj. Deri më tani (e mërkurë, 6 maj 2026, ora 12:00) KQZ ka pranuar njoftimin për pjesëmarrje në zgjedhje nga 18 parti politike, mospjesëmarrje nga 4 parti politike dhe 1 koalicioni i përbërë nga 2 parti politike”, tha Elezi.

Më tej, sipas tij, “këto obligime vlejné vetëm për 53 partitë politike që aktualisht janë pjesë e regjistrimit të partive politike të regjistruara në Republikën e Kosovës”. Sipas Elezit, partitë politike që deri në këtë kohë kanë njoftuar pjesëmarrjen në zgjedhje janë: Partia Socialdemokrate; Kosovaki Nevi Romani Partia; Partia Socialdemokrate e Ashkalinjve; Za Slobodu Pravdu i Opstanak; Srpska Lista; Yenilikçi Türk Hareket Partisi; Lidhja Demokratike e Kosovës; Fjala; Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës; Partia Rome e Bashkuar e Kosovës – PREBK; Socialdemokratska Unija; Jedinstvena Goranska Partija; Kosova Demokratik Türk Partisi; Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës; Nova Demokratska Stranka; Partia Liberale Egjiptiane; Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës; dhe Kosovski Savez. Ndërkaq, sipas tij, partitë politike që deri më tani kanë njoftuar mospjesëmarrjen në zgjedhje janë: Partia Demokratike e Unitetit, Balli Kombëtar i Kosovës, Lëvizja Qytetare Vatra dhe Bashkimi



për Ndryshim Anamorava. Sipas të dhënave të KQZ-së, 6 ditë nga hapja e afatit për deklarim të koalicioneve, KQZ ka pranuar vetëm njoftimin për formimin e koalicionit nga dy parti boshnjake. Bëhet fjalë për Demokratska Stranka Bošnjaka dhe Demokratska Stranka Vatan, që kanë paraqitur në KQZ koalicionin me emrin “Koalicija VAKAT”. Sipas KQZ-së, njoftimi nga partitë politike të regjistruara i pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes në zgjedhje dhe formimi i koalicioneve është një proces tjetër nga

aplikimi për certifikim i subjekteve të reja politike dhe dorëzimi i listës së kandidatëve për deputetë. Sipas Elezit, afati për aplikim për certifikim të subjekteve të reja politike ka filluar më 2 maj dhe do të përfundojë më 10 maj. “Duke filluar nga data 2 maj dhe deri më 10 maj, subjektet e reja politike (koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur) duhet të dorëzojnë në KQZ, respektivisht në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar, aplikimin për certifikim për

pjesëmarrje në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, partia politike konsiderohet automatikisht e certifikuar, andaj ky proces do të vlejë vetëm për subjektet e reja politike, që në këtë rast janë koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur”, tha Elezi. Ndërkaq, po sipas tij, dorëzimi i listës së kandidatëve për deputetë nga subjektet politike ka filluar më 2 maj dhe do të përfundojë më 12 maj 2026. “KQZ ka vendosur afatin 11 ditor, nga 2 maj deri më 10 maj 2026, për subjektet politike (partitë politike, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur) për ta dorëzuar listën me emrat e kandidatëve për deputetë për t’u certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhjet e parakohshme të 7 qershorit. Dorëzimi i listës me emrat e kandidatëve për deputetë duhet të bëhet përmes platformës elektronike dhe procedura është e ngjashme me zgjedhjet e fundit që u mbajtën në dhjetor të vitit të kaluar”, tha Elezi.

## LDK-ja PAJTOHET TË GAROJË SË BASHKU ME ISH-PRESIDENTEN OSMANI NË ZGJEDHJET E QERSHORIT

PRISHTINË, 6 MAJ - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës në opozitë (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se janë pajtuar me ish-presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, për të garuar në një listë të përbashkët në zgjedhjet e parakohshme të 7 qershorit. Duke folur për medie në Prishtinë, Abdixhiku tha se marrëveshja me Osmanin nuk është finalizuar ende dhe se ajo duhet të miratohet formalisht në mbledhjen e partisë të shtunën. “Votuar dhe u dakorduar që të formalizojmë tash e tutje, në bashkëpunim me Vjosa Osmanin, garimin e përbashkët në zgjedhjet e ardhshme. Po për këtë, më jepni edhe disa ditë t’i finalizoj diskutimet edhe me zonjën Osmani, për të përfunduar në një votim formal në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm”, tha Abdixhiku. Kur u pyet nëse Osmani do të rikthehet në LDK si anëtare e partisë apo do të bashkëpunojë me të përmes një partive të veten, Abdixhiku nuk deshi të përgjigjej. Osmani, e cila nuk arriti të zgjidhej presidente për një mandat të dytë në mungesë të mbështetjes në Kuvend pasi i mbaroi mandati në prill, ka vendosur të jetë pjesë e garës zgjedhore në qershor. Ajo nuk ka treguar se si do të garojë, me një parti të re të veten, apo do të rikthehet në LDK pas gjashtë

vjetëve. Megjithatë, 43-vjeçarja ka vizituar vazhdimisht qytete dhe vende të ndryshme të Kosovës përgjatë javëve të fundit, duke takuar qytetarë të ndryshëm. Të hënën ajo e paraqiti kandidaten e parë për deputete, duke lënë të kuptohet se do ta ketë një listë të veten për këtë garë. Duke e paraqitur Fahrije Hotin, ajo tha “po i bashkohet rrugëtimit tonë politik, sepse ne besojmë në një Kosovë ku dashuria e mund urrejtjen, integriteti dhe puna e ndershme e mundin manipulimin, dhe e vërteta e mund propagandën”. Hoti është aktiviste dhe sipërmarrëse, e njohur për fuqizimin e grave pas luftës përmes një kooperative të suksesshme në Krushë të Madhe. Rikthimi i Osmanit në garën politike vjen gjashtë vjet pasi ajo u nda nga LDK-ja në vitin 2020, duke ndërtuar aleancë me Albin Kurtin, kryeministrin në detyrë dhe kryetarin e partisë në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, përmes iniciativës Guxo. Ajo e kishte nisur angazhimin politik pikërisht në LDK, duke u zgjedhur për herë të parë deputete në Kuvendin e Kosovës në vitin 2011, dhe duke u rizgjedhur në disa mandate radhazi, duke u bërë një nga figurat më të spikatura të



partisë. Tani rikthimi i Osmanit në garën politike po ndodh në një moment kur opozita në Kosovë po përballet me mungesë udhëheqjeje dhe narrativash, sipas Donika Eminit, hulumtuese në Grupin Këshillues për Politikën e Ballkanit në Evropë - BiEPAG. Në këtë kontekst, Osmani përfaqëson një “profil ndryshe”, tha ajo për Radion Evropa e Lirë. Sipas Eminit, ish-

presidentja është një nga të paktat figura që mund t’i sfidojë ekuilibrat dhe ta rrisë nivelin e konkurrencës politike. “Ajo mund të tërheqë votues të pakënaqur nga parti të ndryshme, përfshirë Vetëvendosjen dhe parti të opozitës. Kjo e bën atë potencialisht një faktor që ‘rremben’ vota më shumë sesa një aktor që mobilizon vetëm një kamp të caktuar”, thotë Emini. “Hyryja e saj në politikën

aktive nuk do të ishte vetëm një shtesë në skenë por, potencialisht, një faktor që mund t’i ‘tronditë’ balancat ekzistuese”, përfundon ajo. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë do të mbahen më 7 qershor pasi vendi dështoi ta zgjedhë një president të ri për t’i shmangur ato. Këto janë zgjedhjet e treta parlamentare brenda më pak se një viti e gjysmë.

## Komandanti i FSK-së po merr pjesë në panairin "SAHA Expo 2026"

PRISHTINË, 6 MAJ - Komandanti i FSK-së, gjeneralletjenant Bashkim Jashari, i shoqëruar nga delegacioni i FSK-së, po merr pjesë në panairin "SAHA Expo 2026" në Stamboll, në një ndër ngjarjet më të rëndësishme në industrinë e mbrojtjes.

Fillimisht, gjeneral Jashari mori pjesë në ceremoninë zyrtare të hapjes, ku u takua me drejtuesit e Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së

Turqisë.

Gjatë këtij takimi ai paraqiti objektivat e tij për zhvillimin e Forcës dhe diskutoi planet dypalëshe që lidhen me trajnimet, stërvitjet, pajisjet dhe aktivitetet e tjera të përbashkëta.

Gjatë këtij organizimi GLT Jashari ndoqi nga afër zhvillimet teknologjike në industrinë e mbrojtjes në përputhje me objektivat për modernizimin e kapaciteteve tona.

Delegacioni zhvilloi, gjithashtu, takime me prodhues të ndryshëm, me fokus në forcimin e kapaciteteve ushtarake të FSK-së për përmbushjen e misionit të saj.

SAHA EXPO 2026 është një platformë kyçe për forcimin e bashkëpunimit me partnerët, ku pjesëmarrja e FSK-së ndihmon në zhvillimin e aftësive tona moderne në përballimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë.



## KOSOVA DHE MBRETËRIA E BASHKUAR FORCOJNË PARTNERITETIN NË MBROJTJE DHE SIGURI

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 MAJ - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Gegë Lleshi, ka pritur të mërkurën në takim ministrin e Shtetit për Mbrojtje të Mbretërisë së Bashkuar, Lord Vernon Coaker, i shoqëruar nga ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves dhe delegacioni i tij.

Në takim mori pjesë edhe zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralmajor Enver Cikaqi, si dhe zyrtarë dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Gjatë takimit u konfirmua partneriteti strategjik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar si dhe u vlerësua bashkëpunimi i deritanishëm në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.



Theks i veçantë iu kushtua zhvillimit të kapaciteteve profesionale të FSK-së përmes trajnimeve dhe edukimit

ushtarak si dhe forcimit të koordinimit në çështjet e sigurisë.

Zëvendësministri Lleshi theksoi

rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme të Mbretërisë së Bashkuar në rritjen e efikasitetit dhe kapaciteteve të FSK-së si dhe

në avancimin e pozitës së Kosovës në arkitekturën euroatlantike të sigurisë.

Gjatë diskutimeve u trajtuan edhe çështje me interes të përbashkët, përfshirë mbështetjen për Ukrainën, rolin e KFOR-it dhe mundësitë për thellimin e bashkëpunimit operacional ndërmjet institucioneve të mbrojtjes.

Po ashtu, u riafirmua përkushtimi i Republikës së Kosovës për anëtarësim në NATO si dhe gatishmëria për të kontribuar në operacione paqeruajtëse në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë.

Të dyja palët u pajtuan për vazhdimin e koordinimit dhe për identifikimin e hapave konkretë për thellimin e mëtejme të partneritetit bilateral ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar në funksion të paqes, stabilitetit dhe sigurisë së përbashkët.

## KOMUNAT KËRKOJNË QË PAGESAT PËR STAFIN MBËSHTETËS NË SHKOLLA GJATË PROCESIT ZGJEDHOR TË KRYHEN NGA KQZ-ja



Prishtinë, 6 maj - Kryetarët e komunave të Kosovës kërkojnë që stafi mbështetës i shkollave, i angazhuar në procesin zgjedhor dhe në qendrat e numërimit, të paguhet drejtpërdrejt nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe jo nga komunat.

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Agim Aliu, i është drejtuar me një kërkesë Kreshnik Radoniqit, kryetar i Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve: "Siç jeni në dijeni, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), gjatë procesit zgjedhor, po obligon komunat e Republikës së Kosovës që të mbulojnë pagesat për mirëmbajtësit e shkollave nëpër komuna. Në anën tjetër, Departamenti i Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave ende nuk i ka ekzekutuar shtesat për këtë staf nga zgjedhjet e kaluara. Në këtë kontekst, në emër të komunave

të Republikës së Kosovës, kërkojmë që stafi mbështetës i shkollave, i angazhuar në procesin zgjedhor dhe në qendrat e numërimit, të paguhet drejtpërdrejt nga KQZ dhe jo nga komunat. Gjithashtu, theksojmë se komunat tashmë përballen me vështirësi të theksuara buxhetore, veçanërisht në kategorinë e pagave dhe mëditjeve", thuhet në letrën e kryetarit Aliu.

## Tahiri thotë se qeveria në dorëheqje s'ka mandat për emërimet, konkurset për pozita të larta cenojnë ligjin

PRISHTINË, 6 MAJ - Ish-shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se qeveria në dorëheqje nuk është thjesht qeveri "në pritje", por qeveri me kompetenca të kufizuara. "Sipas Ligjit për Qeverinë, konkretisht neni 31,

përcaktohet qartë se një qeveri në dorëheqje nuk duhet të iniciojë procedura të reja për emërimet në pozita publike. Po ashtu, kjo gjendje përfshin edhe periudhën pas shpërndarjes së Kuvendit deri në zgjedhjen e qeverisë së re", ka shkruar Tahiri

në "Facebook".

Ai ka thënë se shpallja e konkurseve për rreth 20 pozita të larta udhëheqëse nga një qeveri në dorëheqje ngre shqetësime serioze ligjore dhe institucionale. "Këto veprime jo vetëm që bien ndesh me frymën

e kufizimeve ligjore, por krijojnë edhe perceptimin e kapjes së institucioneve në një moment tranzicioni, kur vendimet e mëdha duhet t'i lihen legjitimitetit të ri. Respektimi i ligjit nuk është opsion, është detyrim", ka shkruar Tahiri.



**Murati në Bruksel rikonfirmon përkushtimin e qeverisë për zbatimin e reformave në kuadër të Planit të Rritjes**

Prishtinë, 6 maj - Me ftesë të Presidencës së Këshillit të Bashkimit Evropian, ministri i Financave, Hekuran Murati, mori pjesë në Dialogun Vjetor Ekonomik dhe Financiar me partnerët rajonalë, i mbajtur në Bruksel në margjinat e takimit të Këshillit për Çështje Ekonomike dhe Financiare (ECOFIN).

Gjatë fjalës së tij ministri Murati theksoi se ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 3.6 % pavarësisht prej tronditjeve nga jashtë, duke reflektuar qëndrueshmërinë makroekonomike dhe efektin e politikave të përgjegjshme fiskale. Ai, po ashtu, rikonfirmoi përkushtimin e qeverisë për

zbatimin e reformave në kuadër të Planit të Rritjes, me fokus në zhvillimin ekonomik dhe avancimin e integritimit evropian. Në takim morën pjesë ministrat e financave të presidencave të Këshillit të BE-së si dhe përfaqësues të Komisionit Evropian dhe Bankës Qendrore

Evropiane. Ky dialog shërben si platformë e rëndësishme për koordinimin e politikave ekonomike ndërmjet BE-së dhe partnerëve rajonalë, duke i mundësuar Kosovës forcimin e bashkëpunimit me institucionet evropiane dhe harmonizimin me standardet e BE-së.

**AKSION NË AGJENCINË KADASTRALE, DYSHIME PËR FALSIFIKIM DOKUMENTESH DHE KEQPËRDORIM TË DETYRËS ZYRTARE**

Prishtinë, 6 maj - Prokuroria Themelore në Prishtinë, përkatësisht Departamenti i Krimeve të Rënda - Njësi për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, ka njoftuar se në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës ka zhvilluar një aksion të mërkurën në Agjencinë Kadastrale të Kosovës si dhe në disa lokacione të tjera. Ky aksion është realizuar në bazë të urdhërësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë për kontroll ndaj të dyshuarve lidhur me veprën penale "Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo Autoritetit Zyrtar", sipas nenit 414 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe "Falsifikimi i dokumenteve" nga neni 390 të KPRK-së, si dhe

Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë" sipas nenit 395 të KPRK-së.

Sipas dyshimeve të bazuara, të dyshuarit A. Q. dhe N. K., në bashkëveprim dhe pas një marrëveshje paraprake, kanë përdorur një dokument të falsifikuar të titulluar "Kontratë për këmbim e paluajtshmërive" të datës 11.02.1966. Përmes këtij dokumenti është paraqitur në mënyrë të rreme kinse ka ndodhur një këmbim pronash në vitin 1966 me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror.

Gjatë hetimeve është dyshuar se A. Q. dhe N. K., me ndihmën e personit zyrtar A. B., kanë arritur që dokumentin e falsifikuar ta paraqesin si autentik, duke



vulosur dhe përfshirë në arkivat e gjykatës, ndonëse një dokument i tillë nuk ka ekzistuar asnjëherë në evidencat zyrtare. Po ashtu, i dyshuari A. B., në cilësinë e personit zyrtar në

Gjykatën Themelore në Prishtinë, dyshohet se ka keqpërdorur detyrën zyrtare duke krijuar dosje fiktive dhe duke mundësuar legalizimin e dokumentit të falsifikuar me

qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete dhe persona të tjerë.

Ndërkohë, të dyshuarit B. Sh. dhe M. B., në cilësinë e personave zyrtarë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, dyshohen se kanë tejkaluar kompetencat e tyre dhe në mënyrë të kundërligjshme kanë aprovuar ankesën e palës, përkatësisht të pandehurit N. K., duke e obliguar komunën e Prishtinës ta regjistrojë pronën në emër të tij.

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka njoftuar se mbetet e përkushtuar për luftimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit dhe do të vazhdojë t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore në këtë drejtim.

**KEK-u NDAL NJËSINË A4 SI PASOJË E RRJEDHJEVE TË UJIT NË KALDAJË**

PRISHTINË, 6 MAJ - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka bërë me dije se Njësia A4 e Termocentralit "Kosova A" është ndalur në mënyrë të kontrolluar si pasojë e rrjedhjeve të ujit në kaldajë, konkretisht në zonën e tejnxehtësit. Sipas KEK-ut, stafi profesional i TC Kosova A ka vlerësuar se ndalimi i njësisë ka qenë i domosdoshëm dhe në përputhje të plotë me standardet teknike dhe të sigurisë, me qëllim të parandalimit të dëmtimeve më të mëdha dhe të paparashikueshme në pajisje. "Ndërkohë, falë bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet Korporatës Energjetike të



Kosovës (KEK) dhe Korporatës Energjetike Shqiptare (KESH), në situata të tilla është siguruar një pjesë e konsiderueshme e kapacitetit të munguar përmes shkëmbimit të energjisë me KESH, deri në rikthimin e njësisë në operim, duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit të furnizimit me energji elektrike. Lidhur me raportimet se aktualisht në operim është vetëm një njësi nga gjithsej pesë, sqarojmë se këto interpretime janë të pjesshme dhe nuk pasqyrojnë gjendjen reale të sistemit prodhues. Aktualisht, tri njësi (B1, B2 dhe A5) ndodhen në remont të rregullt dhe në proces të zbatimit të projekteve madhore të

rehabilitimit dhe modernizimit, konform Bilancit Vjetor Energjetik. Këto ndërhyrje janë të planifikuara dhe thelbësore për rritjen e besueshmërisë dhe performancës afatgjate të kapaciteteve prodhuese", ka njoftuar KEK-u.

KEK-u ka theksuar se ekipet profesionale janë në gatishmëri të plotë dhe, sapo të krijohen kushtet teknike (pas fitohjes së njësisë), do të bëhet identifikimi i saktë i burimit të rrjedhjeve, pas së cilës do të fillojë menjëherë procesi i sanimit. "Qëllimi mbetet rikthimi i njësisë në operim në afatin më të shkurtër të mundshëm", ka njoftuar KEK-u.

**4 699 biznese të reja janë regjistruar gjatë periudhës janar-prill të këtij viti**

PRISHTINË, 6 MAJ - Në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare (ARBK), që vepron në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), gjatë periudhës janar - prill të këtij viti janë regjistruar 4 699 biznese të reja, ndërsa

janë mbyllur 477 biznese. Gjatë periudhës 1 janar deri më 30 prill 2026 janë regjistruar 4 699 biznese të reja, sipas llojit të bizneseve: 1 119 biznese individuale; 3 561 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar; 12 degë të shoqërive të huaja; 6 shoqëri aksionare; 1

zyrë e përfaqësues së huaj. Po gjatë kësaj periudhe janë mbyllur 477 biznese, sipas llojit të bizneseve: 371 biznese individuale; 99 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar; 6 degë të shoqërive të huaja; 1 ortakëri e përgjithshme. Ministria e Industrisë,

Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit dhe Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare kanë theksuar se mbeten të përkushtuara për mbështetje të përhershme të bizneseve, duke garantuar cilësi, shpejtësi dhe përkushtim në çdo shërbim.



# TURQIA, AMBICIET E ERDOGANIT BRENDA NATO-S



Nuk ka kaluar shumë kohë që kur Turqia konsiderohej një problem brenda NATO-s, megjithatë sot aleatët duket se nuk lodhen duke nënvizuar pozicionin e saj strategjik. Çfarë roli mund të luajë vendi tani që mbështetja e Uashingtonit duket e pasigurt?

Së pari, mes vendeve të NATO-s, Ankaraja ka ushtrinë e dytë më të madhe pas Shteteve të Bashkuara: afërsisht 370 mijë ushtarë. Për më tepër, ajo ka në territorin e saj disa baza të NATO-s, ku janë të dislokuara trupa dhe sisteme radarësh.

Në mars 2026 u bë e qartë edhe rëndësia e NATO-s për sigurinë turke, kur disa raketa balistike të lëshuara nga Irani drejt Turqisë u rrëzuan nga sistemi i mbrojtjes ajrore i aleancës atlantike.

Ankaraja është e shqetësuar për një të ardhme të NATO-s pa Shtetet e Bashkuara, por në të njëjtën kohë sheh edhe

mundësi, shpjegon Riccardo Gasco, koordinator i politikës së jashtme pranë qendrës studimore IstanPol. “Ajo mendon se mund të mbushë boshllëkun që do të linte Uashingtoni, por nga ana tjetër nuk mund ta marrë plotësisht atë rol: mjafton të mendosh për ombrellën bërthamore apo kapacitetet operative ushtarake.” Turqia është një fuqi e mesme, me ambicie rajonale, jo një superfuqi globale si Shtetet e Bashkuara.

Sipas ministrit të jashtëm turk, Hakan Fidan, aktualisht po diskutohet se si të parandalohet tërheqja e Shteteve të Bashkuara nga arkitektura e sigurisë europiane, ose të paktën si të kufizohen pasojat e saj. “Edhe një tërheqje e pjesshme do të ishte shkatërruese për Europën, nëse nuk do të ndodhte në mënyrë të koordinuar”, deklaroi ai në mesin e prillit.

## Në cilën anë është Turqia?

Jo të gjitha vendet europiane anëtare të NATO-s janë entuziaste ndaj idesë së një roli më të madh për Turqinë.

Një çështje delikate mbetet sistemi i mbrojtjes ajrore S-400, të cilin Ankaraja e bleu nga Rusia në vitin 2017, vendi që konsiderohet kundërshtari kryesor i NATO-s.

Thuhet se po zhvillohen bisedime për kthimin e sistemit në Rusi, por çështja ende nuk është zgjidhur. Për më tepër, Turqia nuk është pjesë e Bashkimit Europian dhe, për pasojë, nuk merr pjesë në fondin europian të mbrojtjes SAFE (Security Action for Europe). Madje, Greqia dhe Qipro e shohin një Turqi ushtarakisht më të fortë si kërcënim.

E gjithë kjo krijon një mesazh disi

kontradiktor. “Duke parë realitetin gjeopolitik në ndryshim në Europë dhe Lindjen e Mesme, ne kemi nevojë për Turqinë”, deklaroi më 21 prill komisionerja europiane për zgjerimin, Marta Kos.


Sipas saj, Ankaraja është “thelbësore” për rrugët tregtare dhe për marrëdhëniet me Ukrainë. “Por”, shtoi Kos, “presim gjithashtu që ajo të ndërmarrë hapa për t’u afruar me ne dhe me Qipron.”

Çështja qipriote, ishulli i ndarë mes Republikës së Qipros dhe Republikës Turke të Qipros Veriore, e pushtuar dhe e njohur vetëm nga Ankaraja, nuk pritet të zgjidhet shpejt.

Ndërkohë, disa vende europiane po nisin marrëveshje dypalëshe me Turqinë. Gasco përmend, për shembull, bashkëpunimin mes kompanisë italiane Leonardo dhe prodhuesit turk të dronëve Baykar. Nëse kjo nismë do të ketë

sukses, statusi i Turqisë si një partner i besueshëm në sektorin e mbrojtjes do të forcohet më tej, parashikon analisti.

Zhvillimet në rajon, dhe veçanërisht pushtimi rus i Ukrainës, e kanë bërë Turqinë aq të rëndësishme për qeveritë europiane, sa këto nuk mund t’ia lejojnë vetes të flasin hapur kundër represionit të brendshëm, i cili është rritur vitet e fundit dhe ka çuar në arrestimin e shumë politikanëve të partisë opozitare. Prandaj, rrëshqitja autoritare e vendit nuk pritet të jetë një temë qendrore në samitin e NATO-s që do të mbahet në Ankara më 6 dhe 7 korrik, “ndoshta më i rëndësishmi në historinë e aleancës”, sipas ministrit Fidan. Ai pret pjesëmarrjen edhe të presidentit amerikan Donald Trump: “Për respekt personal ndaj kreut tonë të shtetit, Recep Tayyip Erdoğan.” / “Trouw” – Bota.al



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

## Rapidi synon transferimin e Meriton Korenicës

**BUKURESHT, 6 MAJ** - Futbollisti i Kombëtares së Kosovës, Meriton Korenica, mund të ndërrojë skuadër në verë, por jo edhe kampionat. Korenica mund të transferohet nga

Cluji te Rapid Bukureshti, ka raportuar mediumi "Fanatik". Korenica pritet t'i bashkohet trajnerit aktual të Clujit, Daniel Pancu, i cili ka arritur marrëveshje për ta drejtuar

Rapidin nga edicioni i ardhshëm. Në mesin e katër lojtarëve që Pancu synon t'i afrojë te Rapid është edhe futbollisti Meriton Korenica. Korenica 29-vjeçar me Clujin

ka kontratë deri në verën e vitit 2027. Ai ka realizuar 12 gola në të gjitha garat e edicionit aktual dhe ka kontribuar me nëntë asistime për Clujin.



## KOMITETI EKZEKUTIV I FFK-së VLERËSON POZITIVISHT ECURINË E GARAVE DHE PËRPARIMIN E EKIPEVE KOMBËTARE

**PRISHTINË, 6 MAJ** - Komiteti Ekzekutiv (KE) i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) ka mbajtur mbledhjen e radhës nën drejtimin e presidentit Agim Ademi, ku janë trajtuar çështje me rëndësi për zhvillimin dhe organizimin e futbollit në vend. Në hapje të mbledhjes, presidenti Ademi u ka uruar mirëseardhje anëtarëve të rinj të KE-së, Enver Muzliukaj dhe Armend Misini, duke theksuar rëndësinë e kontributit të tyre në vendimmarrjen strategjike të federatës. Gjatë mbledhjes është miratuar unanimisht procesverbal i mbledhjes së kaluar, ndërsa diskutimet kryesore u përqendruan në ecurinë e garave vendore, performancën e ekipeve kombëtare dhe zhvillimin e infrastrukturës.

Komiteti Ekzekutiv ka vlerësuar se garat në të gjitha nivelet janë duke u zhvilluar me intensitet dhe rivalitet të lartë. Superliga është cilësuar tejet konkurruese si në luftën për pjesëmarrje në garat evropiane, po ashtu edhe në betejën për mbijetesë. "U theksua niveli i lartë konkurrues në Ligën e Parë, ku disa skuadra me traditë janë në garë për inkuadrim në elitë dhe për pozitën e barazhit. Në këtë kontekst, për shkak të rëndësisë së ndeshjeve dhe mungesës së sistemit VAR në të gjitha stadiumet, u la e hapur mundësia që ndeshje të caktuara të zhvillohen në terminë të ndryshëm, me qëllim që të ketë sa më shumë drejtësi në ndeshjet vendimtare. U theksua përkushtimi maksimal i të gjitha

organeve të FFK-së, për angazhimin e gjyqtarëve dhe zyrtarëve më të mirë në ndeshjet e fundit të këtij edicioni, në mënyrë që ndeshjet të zhvillohen në mënyrë sa më të rregullt dhe me drejtësi maksimale", ka njoftuar FFK-ja.

KE-ja ka vlerësuar se kampionati vendor ka shënuar përparim të dukshëm falë përmirësimit të infrastrukturës, sigurimit shëndetësor të futbollistëve dhe rritjes ekonomike të klubeve. "Njëkohësisht u konstatua se integriteti i garës nuk është cenuar pavarësisht prej zërave të izoluar për manipulim të ndeshjeve, ndërsa u theksua edhe një herë se të gjitha ndeshjet monitorohen nga mekanizmat përkatës vendorë dhe ndërkombëtarë, teksa u bë thirrje që kushdo që ka fakte konkrete t'i paraqesë ato në organet e FFK-së, por edhe në institucionet shtetërore. Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm u theksua nevoja për vendosjen e kriterëve edhe më të larta për klubet e Superligës si në aspektin organizativ, po ashtu edhe në atë infrastrukturor, ndërkohë që një ekspert i FIFA-s tashmë ka nisur procesin e vlerësimit dhe kategorizimit të stadiumeve", është thënë në njoftim.

Komiteti Ekzekutiv ka diskutuar edhe për avancimin e futbollit të vajzave, ku është theksuar nevoja për reformatim të garave me qëllim rritjen e konkurrencës. Sipas kërkesave të UEFA-s, nga edicioni i ardhshëm pritet që klubet e Superligës t'i kenë edhe ekipet e vajzave si pjesë e



detyrimeve për zhvillimin gjithëpërfshirës të futbollit. "Gjithashtu, u theksua nevoja që Superliga U19 të ketë vëmendje më të madhe nga vetë klubet, pasi ajo vlerësohet ligë që mundëson zhvillimin e talenteve dhe promovimin e tyre në arenën evropiane përmes UEFA Youth League, si dhe duke pasur parasysh interesimin e madh të skautëve dhe klubeve evropiane për këtë grupmoshë. Komiteti Ekzekutiv vlerësoi lart paraqitjet e Kombëtares A në ciklin kualifikues për Kupën e Botës 2026, duke theksuar se ekipi ka tejkaluar pritshmëritë dhe ka ndërtuar një imazh shumë pozitiv ndërkombëtar. U shpreh keqardhje që fati nuk ishte me Dardanët në finalen kundër Turqisë dhe nuk u arrit realizimi i ëndrrës së madhe për kualifikim në Botërorin 2026, që do të ishte edhe një promovim i madh për shtetin e Kosovës, por u potencua edhe jehona që ka bërë në tërë globin arritja deri në finale të 'play-off'-it si dhe progresi në renditjen e FIFA-s dhe rezultatet e

arritura ndaj kundërshtarëve të fortë evropianë", ka njoftuar FFK-ja.

Në këtë drejtim është konfirmuar se do të vazhdohet me prurje të reja në Kombëtare, ndërsa në funksion të përgatitjeve për garat e ardhshme, së shpejti pritet të zyrtarizohen edhe ndeshje miqësore për muajin qershor. "U vlerësuan edhe paraqitjet e Kombëtares U21, Kombëtares së vajzave, e cila kryeson grupin në kualifikimet për Botërorin 2027 në Ligën C, si dhe Kombëtares së futsallit, që ka kaluar fazën e parë kualifikuese për Botëror, duke i inkurajuar që edhe në ndeshjet e ardhshme të vazhdojnë në kërkim të rezultateve pozitive për realizim të objektivave. Në fushën e infrastrukturës, u konstatua se FFK ka tejkaluar obligimet e saj përmes investimeve të vazhdueshme në projekte të rëndësishme, siç janë fushat stërvitore. Por, KE shprehu gatishmërinë për të vazhduar investimet në infrastrukturë me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kushteve për futboll.

Shumë shpejt do të fillohet me realizimin e projektit të ndriçimit të stadiumeve, i cili pritet të nisë me instalimin e reflektorëve në tri prej stadiumeve me bari natyral, për të vazhduar më pas me stadiumet e tjera. Po ashtu, është duke u hartuar një projekt për ndërtimin e tribunave të reja në disa stadiume, me qëllim përmirësimin e kushteve për tifozët. Në këtë proces, u theksua rëndësia e bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe lokale", ka njoftuar FFK-ja.

Sa i përket Kampit Nacional të FFK-së është bërë me dije se për stadiumin kryesor është në proces sigurimi i pajisjes së ulësive me kapacitet prej 16 mijë e 800 vendesh. "Gjatë mbledhjes u trajtua edhe çështja e pjesëmarrjes së ekipeve kombëtare në Lojërat Mesdhetare 2026, ku u arrit pajtueshmëri që Kombëtarja U19 e vajzave të përfaqësojë Kosovën. Me këtë rast, u theksua se KOK-u ka bërë lëshim të madh duke mos e njoftuar me kohë FFK-në për ftesën e pjesëmarrjes në këtë garë të rëndësishme. Po ashtu u konfirmua se ndeshja e Superkupës Kosovë - Diasporë do të zhvillohet më 9 maj në Cyrih, ndërmjet FC Kosova Cyrih dhe FC Prishtina, derisa mbështetje financiare për organizimin e saj ka ofruar edhe ministria. Në përmblyllje, Komiteti Ekzekutiv shqyrtoi dhe miratoi edhe disa kërkesa dhe parashtesa të paraqitura, duke vazhduar angazhimin për zhvillimin e qëndrueshëm të futbollit në vend", ka njoftuar FFK-ja.

## Henry zbulon tri kombëtares favorite për Kupën e Botës 2026

**PARIS, 6 MAJ** - Legjenda franceze Thierry Henry ka vlerësuar ekipet kombëtare para nisjes së Kupës së Botës 2026, teksa nuk ka hezituar të tregojë tre emra që ai mendon se do ta thonë fjalën e fundit për titullin e kampionit botëror. Si një ish-sulmues legjendar i Kombëtares franceze dhe një nga

sulmuesit më të frytshëm në historinë e futbollit, Henry mbetet një zë i shquar në këtë sport. I njohur për mprehtësinë e tij taktike dhe karrierën e tij të shkëlqyer ndërkombëtare, ai kohët e fundit ka ofruar analizën e tij mbi pretendentët kryesorë për turneun e ardhshëm global. "Duhet ta respektosh

Argentinën sepse është kampione në fuqi e botës. Është ende një ekip i fortë dhe Messi është numri 10 i tyre", ka thënë Henry.

Më pas Henry ka vlerësuar kandidatët e tjerë për zgjedhjet paraprake, përfshirë kombin e tij. "Pastaj jemi ne, Franca. Kemi një ekip të shkëlqyer dhe kemi luajtur në

dy finale radhazi. Dhe pastaj është Spanja. Më habit fakti që, pavarësisht prej lojtarëve, ata gjithmonë veprojnë në të njëjtën mënyrë, në të njëjtin stil tërheqës, dhe është shumë e vështirë t'ua marrësh topin", ka thënë Henry, duke shprehur besim të madh në trajktoren e ekipit kombëtar francez.





Prishtinë, 07.05.2026

### NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „L&D ENERGY SOLUTION“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 812109454 me adresë: Rr. „Mazllam Kastrati, Tranziti i Vjetër“ pn, Komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 14.04.2026 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panellet solare me kapacitet të instaluar prej 1 MW ZK Petrovë, Komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës.

Shoqëria „L&D ENERGY SOLUTION“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 1 MW ZK Petrovë, Komuna e Prizrenit, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.4363-2/25 dt. 18.08.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Njoftimin Nr. 04-353/01-21408 të dt. 07.03.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Aktvendimin nr. 04-353/01-135622 të dt. 10.10.2025 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Nr.04-353/01-22408 dt. 19.03.2026, për “Vendosjen e paneleve solare fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 1 MW, ngastrata katastrale 00142-1 ZK Petrovë, gjegjësisht në objektin me nr. 24-0 ZK Petrovë, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit.
- Pëlqimin Elektroenergetik Nr. 4131 dt. 24.03.2026 të lëshuar nga KEDS SIIA.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: [luan@ild-prizren.com](mailto:luan@ild-prizren.com), [crzcn.krasniqi@solar2.eu](mailto:crzcn.krasniqi@solar2.eu) dhe [LEGAL-LECEINING@cro-ks.org](mailto:LEGAL-LECEINING@cro-ks.org)

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Bavaria Bau” SH.P.K. pronar Gent Sejdiu me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812006973 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Bavaria Bau” D.O.O. Gent Sejdiu Gnjilane donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812006973 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Bavaria Bau” L.L.C. with owner Gent Sejdiu with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812006973 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156



+386 49 848 553

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Diellëzon Krasniqi nga Damjani i Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Kongresi i Manastirit”, Damjan, nga klasa 1-5 dhe 6-9.
- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Vilson Gjykej nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.
- Albrim Sylja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Andi Firzi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 marsi” Prizren.
- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.
- Francez Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Zef Lush Marku” Velezhe.
- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.
- Kristijan Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IXshfmu “ Zef Lush Marku” Velezhe.
- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Mensur Morina shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.
- Kreshnik Berisha B.I. Rogovë Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 812216259 të lëshuar nga ARBK.
- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Aida Murselaj Çiflak Rahovec shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “FehmiAgani” Gjakovë me numër 200102037.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

